

AL

**UDHËZIME
TË DETAJUARA PËR
PËRDORIMIN E
FRIGORIFERËVE
VERTIKALË DHE
NGRIRËRSVE**

Simplicity
COLLECTION

Ne ju falënderojmë për besimin që keni treguar duke blerë pajisjen tonë elektroshtëpiake, e cila është projektuar për të lehtësuar jetën tuaj. Për ta bërë më të thjeshtë përdorimin e këtij produkti, ne kemi ofruar udhëzimet e detajuara për përdorim dhe udhëzimet e instalimit të dhëna në një fletë të veçantë. Udhëzimet duhet t'ju mundësojnë që të mësoni për pajisjen tuaj elektroshtëpiake të re sa më shpejt që të jetë e mundur.

Ne dëshirojmë që ju të gjeni mjaft kënaqësi gjatë përdorimit të saj.

Pajisja elektroshtëpiake është synuar vetëm për përdorim familjar.

Frigoriferi është synuar për të mbajtur ushqim të freskët në temperaturat mbi 0°C.

Ngrirësi është synuar për të ngrirë ushqimin e freskët dhe për të mbajtur për kohë të gjatë ushqimin e ngrirë (deri në një vit, në varësi të llojit të ushqimit).

Ju lutemi të vizitoni faqen tonë të internetit, në të cilën ju mund të fusni numrin e modelit të pajisjes suaj elektroshtëpiake, të treguar në pllakën e të dhënave në fletën e garancisë, për të gjetur përshkrimin e detajuar të pajisjes suaj elektroshtëpiake, këshillat e përdorimit, zgjidhjen e problemeve, informacion për shërbimin, udhëzimet e përdorimit, etj.



<http://www.gorenje.com>



Këshilla të rëndësishme për sigurinë



Informacion dhe këshilla të përgjithshme



Mbrojtja e mjedisit



Mos e lani në lavastovilje

PËRMBAJTJA

4 SHËNIME DHE REKOMANDIME TË RËNDËSISHME 4 PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË 5 KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË 8 INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE 9 MBROJTJA E MJEDISIT 10 KËSHILLA PËR KURSIMITIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TE APARATET PËR FTOHJE DHE NGRIRJE	HYRJE
11 POZICIONIMI DHE ADERIMI 14 PËRSHKRIMI I APARATIT 15 NDRYSHIMI I DREJTIMIT TË HAPJES SË DERËS 17 VËNIA NË FUNKSIONIM E PAJISJES 23 PAJIMET E BRENDESHME TË APARATIT 27 RRADHITJA E PREFERUAR E ARTIKUJVE USHQIMORË NË APARAT	PËRSHKRIMI I APARATIT
28 RUAJTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË NË FRIGORIFER 33 MBAJTJA E USHQIMIT NË SIRTARIN FreshZone 34 NGRIRJA DHE RUAJTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË TË NGRIRË 34 Procesi i ngrirjes 35 Vërejtje të rëndësishme për ngrirjen e artikujve ushqimorë 35 Ruajtja e artikujve ushqimorë të ngrirë industrialisht 36 Koha e ruajtjes së artikujve ushqimorë të ngrirë 36 Shkrirja e artikujve ushqimorë të ngrirë	RUAJTJA DHE NGRIRJA E USHQIMEVE
37 SHKRIRJA E APARATIT 38 PASTRIMI I APARATIT	SHKRIRJA/ HEQJA E AKULLIT DHE PASTRIMI I PAJISJES
39 EVITIMI I PENGESAVE 41 INFORMATA PËR ZHURMËN E APARATIT	TË TJERA

SHËNIME DHE REKOMANDIME TË RËNDËSISHME

i PËRPARA PËRDORIMIT TË PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE PËR HERË TË PARË

Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake me rrjetin elektrik, ju lutemi të lexoni me kujdes udhëzimet e përdorimit të cilat përshkruajnë pajisjen elektroshtëpiake dhe përdorimin e saj të rregullt dhe të duhur. Udhëzimet zbatohen për disa lloje/modele të pajisjeve elektroshtëpiake; prandaj, këtu mund të përshkruhen parametra ose pajisje të cilat nuk janë të disponueshme në pajisjen tuaj elektroshtëpiake. Ne ju rekomandojmë që ta ruani këtë manual udhëzimi për referenca në të ardhmen dhe ta vendosni bashkë me pajisjen elektroshtëpiake në qoftë se do ta shisni në të ardhmen.

Manuali i udhëzimit përfshin variantin/modelin NO FROST (pa ngrirje) të frigoriferit, i cili është i pajisur me një ventilator dhe në të cilin procesi i shkrijës është automatik (vetëm në disa modele).

Kontrolloni për të gjitha dëmtimet ose parregullsitë në pajisjen tuaj elektroshtëpiake. Në qoftë se konstatooni se pajisja juaj elektroshtëpiake është e dëmtuar, njoftojeni shitësin nga i cili e keni blerë pajisjen elektroshtëpiake.

Përpara se të lidhni pajisjen elektroshtëpiake me rrjetin elektrik, lereni pajisjen elektroshtëpiake të qëndrojë në pozicion vertikal për një minimum prej 2 orësh. Kjo do të zvogëlojë mundësinë e defekteve të operimit për shkak të efekteve të transportit në sistemin e ftohjes.



KËSHILLA TË RËNDËSISHME PËR SIGURINË



KUJDES! Rrezik zjarri/materiale të djegshme.

Pajisja elektroshtëpiake duhet të lidhet me rrjetin elektrik dhe të tokëzohet në përputhje me standardet dhe rregullat në fuqi.

KUJDES! Mos vendosni priza shumëfishe portative ose pajisje elektrike portative në pjesën e pasme të pajisjes elektroshtëpiake.

Përpara se të pastroni pajisjen elektroshtëpiake, shkëputeni nga rrjeti elektrik (hiqeni kabllin e energjisë nga priza e murit).

KUJDES! Në qoftë se kablli i furnizimit është i dëmtuar, duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimit ose persona të tjerë me kualifikim të ngjashëm, në mënyrë që të shmangët rreziku.

KUJDES! Kur të vendosni pajisjen elektroshtëpiake, sigurohuni që kablli i furnizimit të mos jetë i bllokuar ose dëmtuar.

Në qoftë se nuk punon drita LED, thërrisni një teknik shërbimi. Mos u përpiqni të riparoni vetë ndriçimin LED, pasi ka rrezik të kontaktit me tensionin e lartë!



KUJDES! Mos përdorni asnjë pajisje elektrike brenda pajisjes elektroshtëpiake, me përjashtim të atyre që lejohen nga prodhuesi i kësaj pajisjeje frigoriferike.



KUJDES! Mos përdorni asnjë pajisje mekanike ose mjete të tjera për të përshpejtuar procesin e shkrirjes, të ndryshme nga ato të rekomanduara nga prodhuesi.



KUJDES! Për të shmangur ndonjë rrezik të mundshëm i cili rezulton nga qëndrueshmëria e dobët e pajisjes elektroshtëpiake, sigurohuni që ajo është instaluar sipas udhëzimit.

Rrezik nga ngrirja (morthi)

Mos vendosni asnjëherë ushqim të ngrirë në gojë dhe shmangni prekjen e ushqimeve të ngrira, pasi ato mund të shkaktojnë dëmtim nga ngrica ose morth.

Siguria e fëmijëve dhe e personave të dobët

Pajisja elektroshtëpiake nuk ka pë qëllim të përdoret nga personat (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore ose mendore, apo me mungesë përvoja dhe njohurish, përveçse kur ata mbikëqyren ose udhëzohen nga personi përgjegjës për sigurinë e tyre në lidhje me përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake.

Fëmijët duhet të mbikëqyren për të siguruar që ata nuk luajnë me pajisjen elektroshtëpiake.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit nuk duhet të bëhet nga fëmijë të pambikëqyrur.

Hiqeni paketimin e synuar për të mbrojtur pajisjen elektroshtëpiake ose pjesët e veçanta të saj gjatë transportit dhe mbajini larg prejjes së fëmijëve.

Ai paraqet rrezik plagosje ose asfiksimi.

Kur të hiqni një pajisje të përdorur elektroshtëpiake, shkëputeni kabllin e energjisë, hiqeni derën dhe raftet lerini në pajisjen elektroshtëpiake. Kjo nuk do t'i lejojë fëmijët që të mbyllën në pajisjen elektroshtëpiake.

Vetëm për tregjet Evropiane

Kjo pajisje elektroshtëpiake mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e sipër dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore ose mendore, apo me mungesë përvoja dhe njohurish, në rast se ata mbikëqyren ose udhëzohen dhe kuptojnë rreziqet e përfshira në lidhje me përdorimin e pajisjes elektroshtëpiake në mënyrë të sigurt.

Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake.

Pastrimi dhe mirëmbajtja e përdoruesit nuk duhet të bëhet nga fëmijë të pambikëqyrur.

Fëmijët nga mosha 3 deri në 8 vjeç lejohen të vendosin dhe të marrin ushqime në pajisjet frigoriferike.

Përkujdesje në lidhje me frigoriferin.

Pajisja elektroshtëpiake përmban një sasi të vogël gazi R600a, të padëmshëm për mjedisin por të djegshëm. Sigurohuni që nuk do të dëmtohet asnjë pjesë nga sistemi i ftohjes. Një rrjedhje gazi nuk është e dëmshme për mjedisin, por mund të shkaktojë dëmtim të syve ose zjarr. Në rast të rrjedhjes së gazit, ajroseni dhomën plotësisht, shkëputeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik dhe thërrisni një teknik shërbimi.

INFORMACION I RËNDËSISHËM PËR PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTROSHTËPIAKE

KUJDES! Kjo pajisje elektroshtëpiake synohet të përdoret në banesa dhe në aplikime të ngjashme si

- zonat e kuzhinës së stafit në dyqane, zyra dhe mjedise të tjera pune;
- shtëpitë e fermave dhe klientët në hotele, motele dhe në mjedise të tjera banimi;
- në ambientet e tipit shtrat dhe mëngjes;
- në aplikime kateringut dhe të ngjashme jo për tregti.

i KUJDES! Hapësirat e ajrosjes në pjesën e mbyllur ose në strukturën e pajisjes elektroshtëpiake, mbajini të papenguara.

Pajisja elektroshtëpiake nuk mund të përdoret jashtë dhe nuk duhet të ekspozohet në shi.

Mos mbani lëndë shpërthyes si kanaçe aerosoli me gazra të djegshëm të lëvizshëm në këtë pajisje elektroshtëpiake.

Në qoftë se pajisja elektroshtëpiake nuk do të përdoret për një periudhë të gjatë kohore, fikeni atë duke përdorur butonin përkatës dhe hiqeni nga rrjeti elektrik. Boshatiseni pajisjen elektroshtëpiake, shkrijeni, pastrojini dhe lëroni derën të hapur.

Në rast defekti ose mosfurnizimi me energji elektrike, mos e hapni njësinë e ngrirjes për aq kohë sa ngrirësi nuk ka operuar për rreth 16 orë. Pas kësaj periudhe, përdoreni ushqimin e ngrirë ose siguronit ftohje të mjaftueshme (p.sh. një pajisje elektroshtëpiake zëvendësuese).

Informacion teknik për pajisjen elektroshtëpiake

Pllaka e të dhënave mund të gjendet në pjesën e përparme të pajisjes elektroshtëpiake. Ajo tregon të dhënat për tensionin, vëllimin bruto dhe neto, llojin dhe sasinë e gazit ftohës dhe informacionin për klasat klimatike.

Në qoftë se gjuha në pllakën e të dhënave nuk është gjuha e zgjedhjes suaj ose gjuha e vendit tuaj, ndërojeni atë me një nga gjuhët e dhëna.



MBROJTJA E MJEDISIT

Paketimi është bërë nga materiale miqësore me mjedisin të cilat mund të riciklohen, të hidhen ose të shkatërrohen pa asnjë rrezik për mjedisin.



Heqja e një pajisjeje elektroshtëpiake e cila nuk përdoret më

Për të mbrojtur mjedisin, çojeni pajisjen elektroshtëpiake e cila nuk përdoret më në një qendër grumbullimi të pajisjeve elektroshtëpiake.

Përpara se të veproni kështu, bëni sa më poshtë:

- shkëputeni pajisjen elektroshtëpiake nga rrjeti elektrik;
- mos i lejoni fëmijët të luajnë me pajisjen elektroshtëpiake.



KUJDES! Mos e dëmtoni qarkun e gazit ftohës. Kjo gjithashtu mund të ndalojë ndotjen.



Simboli në produkt ose në paketimin e tij tregon se produkti nuk duhet të trajtohet si një mbetje e zakonshme shtëpiake. Produkti duhet të çohet në një qendër të autorizuar grumbullimi për përpunimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike. Hedhja e produktit në mënyrën e duhur mund të ndihmojë në parandalimin e të gjitha ndikimeve negative të cilat mund të ndodhin në mjedis dhe në shëndetin e njerëzve në rast të heqjes jo të rregullt të produktit. Për informacion të detajuar për heqjen dhe përpunimin e produktit, ju lutemi të kontaktoni me organin përkatës bashkiak me detyrën e menaxhimit të mbetjeve, me shërbimin tuaj të hedhjes së mbetjeve ose me dyqanin ku e keni blerë produktin.

KËSHILLA PËR KURSIMITIN E ENERGJISË ELEKTRIKE TE APARATET PËR FTOHJE DHE NGRIRJE

- Aparatin e poziciononi siç është përshkruar në udhëzime.
- Mos hapni derën e aparatit më shpesh se sa është e nevojshme.
- Kohë pas kohe kontrolloni që qarkullimi i ajrit pas aparatit të jetë i papengueshëm.
- Kondensatori në murinë e pasme të aparatit gjithmonë nevojitet të jetë i pastër (shiqo kapitullin Pastrimi i aparatit).
- Guarnicionin e dëmtuar ose joputhitës sa më parë ndërrojeni.
- Artikujt ushqimorë rruani në enët e mbyllura ose të ambalazuara.
- Para se të konservohen, artikujt ushqimorë të ftohen në temperaturën e dhomës.
- Artikujt ushqimorë të ngrirë nevojitet të shkrihen në hapësirën e ftohjes.
- Hiqni disa nga sirtarët e kompartimentit të ngrirësit, ashtu siç përshkruhet në manualin e udhëzimeve në mënyrë që të përdorni të gjithë pjesën e brendshme.
- Ngrirësin klasik e shkrihi pasi që në sipërfaqet e ftohura tubohet përafërsisht 3-5 mm ngricë, resp. akull.
- Rradhitja e rafteve nëpër hapësirë le të jetë e njëtrajtëshme, kurse artikujt ushqimorë të rradhitur ashtu që të sigurohet qarkullimi i papengueshëm i ajrit (merrni në përfillje rradhitjen e rekoman- duar të artikujve ushqimorë siç është e përshkruar në udhëzime).
- Te aparatet me ventilator mos i mbuloni vanat e ventilatorit.
- Në rast se nuk ju nevojitet ventilatori ose ionizatori, ata i shkyçni, për shkak se shtesë harxhojnë energji elektrike.

POZICIONIMI DHE ADERIMI

PËRZGJEDHJA E AMBIENTIT

- Aparatin poziciononi në ambient të thatë dhe të ajrosur. Ai funksionon me rregullsi të temperaturat e rrethit, të cilat i shfaqim në tabelë. Klasa është e cekur në etiketën me të dhënat elementare për aparatin.

Klasa	Temperatura
SN (subnormale)	prej +10°C deri në +32°C
N (normale)	prej +16°C deri në +32°C
ST (subtropike)	prej +16°C deri në +38°C
T (tropike)	prej +16°C deri në +43°C


- i** • Mos e vendosni një pajisje elektroshtëpiake në një dhomë ku temperatura mund të bjerë më poshtë se 5 °C, pasi kjo gjë mund të shkaktojë një operim jonormal ose mosfunksionim të pajisjes elektroshtëpiake!

- Pas instalimit, priza e lidhjes me rrjetin e pajisjes elektroshtëpiake duhet të jetë e prekshme!
- Mos e vendosni pajisjen elektroshtëpiake në afërsi të pajisjeve elektroshtëpiake të cilat rrezatojnë nxehtësi, si sobat e gatimit, sobat e ngrohjes, radiatorët, nxehësat e ujit, etj. Dhe mos e ekspozoni ndaj rrezeve direkte të diellit. Pajisja elektroshtëpiake duhet të qëndrojë të paktën 3 cm larg nga soba e gatimit me gaz ose elektrike ose të paktën 30 cm larg nga soba ngrohëse me naftë ose me lëndë djegëse të ngurta. Në qoftë se distanca midis këtyre burimeve të nxehtësisë dhe pajisjes elektroshtëpiake është më e vogël, përdorni një panel izolues.

Shënim: Vendoseni pajisjen elektroshtëpiake në një dhomë mjaftueshëm të madhe. Duhet të jetë të paktën një hapësirë prej 1 m³ për 8 gram gazi ftohës. Sasia e gazit ftohës tregohet në pllakën e të dhënave në pjesën e brendshme të pajisjes elektroshtëpiake.


- Në bazën e njësisë së kuzhinës, të synuar për të vendosur pajisjen elektroshtëpiake të integruar, duhet të jetë të paktën një hapësirë e lirë prej 200 cm², për qarkullim të përshtatshëm të ajrit. Në pjesën e sipërme të pajisjes elektroshtëpiake, ajri del jashtë, prandaj përpiquni të mos e mbulonit hapësirën për nxjerrjen e ajrit. Mosmarrja parasysh e këtij paralajmërimi mund të shkaktojë dëmtim të pajisjes elektroshtëpiake.

POZICIONIMI I APARATIT




Te pozicionimi i aparatit le të bashkëpunojnë së paku dy persona, që me këtë të parandalojnë lëndimet e personave ose dëmtimet e aparatit.

- Aparati nevojitet të qëndrojë rrafshë ose lehtë i mënjanuar prapa, stabil dhe në dysheme mjaft të fortë. Në anën e parë janë të instaluar këmbëzat rregulluese, me të cilat barazpeshoni aparatin. Në anën e pasme janë rrotëzat që mundësojnë vendosjen më të lehtë të aparatit (i kanë vetëm disa modele).
- Elementi mbi aparatin nevojitet të jetë i çuar për së paku 5 cm, e kjo garanton ftohje të mjaftueshme të kondensatorit.
- Aparatit janë bashkangjitur dy distancues, të cilët i instaloni në pjesën e poshtme të shtëpizës, ku parandalojnë që aparati të mos pozicionohet shumë afër murit. Aparatin mund të poziciononi edhe pa përdorimin e distancuesve, por kjo mund të shkaktojë shpenzim më të lartë të energjisë.
- Mos e vendoni aparatin nën ndikimin direkt të rrezeve të diellit dhe mos e vendoni në afërsi të burimeve të ngrohjes. Nëqoftëse kësaj nuk mund t'i shmangeni, instaloni pllakë izolimi.
- Aparati mund të qëndrojë i pavarur ose e poziciononi pranë elementit mobiljar ose murisë. Merrni në përfillje hapësirën e nevojshme për hapjen e derës të tërheqja e sirtarëve dhe rafteve.




ADERIMI I APARATIT



- Aparatin e aderoni në rrjetën elektrike me kablo aderuese. Priza në muri nevojitet të përmbaj kontakt tokëzues (priza mbrojtëse). Tensioni elementar dhe frekuenca janë të shënuara në etiketën me të dhënat elementare për aparatin.
- Aderimi në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të zbatohen në bazë të rregullave dhe standardeve në fuqi. Aparati përqëndron oscilime afatshkurte të tensionit, por më së shumti prej -6% deri në +6%.

PËRSHKRIMI I APARATIT



A Frigoriferi

- 1 Njësia e kontrollit
- 2 Ndiriçimi LED i pjesës së brendshme të frigoriferit
- 3 Ndarëse xhami që mund të hiqet (lartësia përshtatet sipas dëshirës)
- 4 Rafti për fruta dhe zezavate
- 5 Raftet tek dera e frigoriferit, lartësia e të cilave përshtatet sipas dëshirës
- 6 Rafti për shishe

B Ngrirësi











- 7 Raftet e ngrirësit
- 8 Raftet xhami

- Sirtarët mbrohen ndaj tërheqjes. Për të hequr një sirtar nga pajisja, tërhiqeni atë sa më larg që mund të shkojë, pastaj ngrijeni përpara dhe tërhiqeni plotësisht.
- Disa nga modelet përmbajnë njësinë e komandimit në derë


NDRYSHIMI I DREJTIMIT TË HAPJES SË DERËS

Veglat e nevojshme: Çelësi ngulës nr. 8, kaçavida e kryqëzuar, torx 25, kaçavida e drejtë Te ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës le të bashkëpunojnë së paku dy persona!

1. Evitoni kapakun e menteshesë së epërme (A) dhe kapakëzën nga konektuesi (B1).
2. Shkryçni konektuesin (C), zhvidhoni menteshenë e epërme (D) dhe nxjerrni derën e epërme (E).
3. Evitoni blenditë anëshe (F) dhe (G), e pastaj zhvidhoni dhe evitoni blendën e mesme (H).
4. Menteshenë e epërme (A) bashkarisht me konektuesin dhe kabllonë i transferoni në anën e kundërt, vëndoni sërish të tre blendat (F), (G) dhe (H) - kujdeseni që kabllonë ta vëndoni në vanat e blendave njëjloj siç ka qenë para demontimit!
5. Pastaj evitoni tapotë mbuluese (I), zhvidhoni menteshenë e mesme (J) dhe derën e poshtme (K) nxjerrni nga mentesheja e poshtme (L).
6. Mënjanoni aparatit prapas, zhvidhoni menteshenë e poshtme (L) dhe këmbëzën (M) e transferoni në anën e kundërt. Kujdeseni që të vëndoni rondelën siç ka qenë para demontimit.
7. Zhvendosni kushinetat (N) dhe menteshat e dyerve (S) në anën e kundërt.
8. Menteshenë e mesme (J) vëndoni në derën e poshtme (K), të cilat i instaloni në menteshenë e poshtme (L). Pastaj, menteshenë e mesme vidhoni (dera nevojitet të jetë e hapur). Mos haroni të vëndoni rondelat (O) dhe tapotë mbuluese (I), siç kanë qenë para demontimit.
9. Derën e epërme (E) vëndoni në menteshenë e mesme (J), evitoni kapakëzat mbuluese (P) dhe (B2), kyçni përsëri konektuesin (C) dhe vidhoni menteshenë e sipërme (D).
10. Vëndoni kapakun e menteshesë së epërme (A), kapakëzën e konektuesit (B1) dhe kapakëzat mbuluese (P) dhe (B2).



VËNIA NË FUNKSIONIM E PAJISJES



A Butoni i temperaturës dhe funksioneve ekstra (shtesë)

B Temperatura e vendosur në ndarjen e frigoriferit dhe treguesi i funksionit »eco«

C Treguesi i temperaturës së vendosur në ndarjen e frigoriferit


D Temperatura e vendosur në ndarjen e frigoriferit dhe treguesi i funksionit “mungesë e madhe” (pushim)

E Treguesi i funksionit ngrirje intensive (ngrirje e fortë)

F Treguesi i alarmit për temperaturë të lartë

Për të caktuar temperaturën e pajisjes elektroshtëpiake ose për të aktivizuar funksionet shtesë, shtypeni disa herë butonin A. kur butoni shtypet për herë të parë, do të fillojë të pulsojë vlera e caktuar aktualisht. Me çdo shtypje të mëpasshme të butonit, treguesi kalon në parametrin tjetër. Treguesi qarkullon nëpër parametra në mënyrë ciklike, nga e djathta në të majtë. Ndërkohë që parametrat janë duke u caktuar, ekrani do të pulsojë. Tre sekonda pasi të lëshohet butoni, parametri do të ruhet automatikisht dhe do të ndriçojë simboli përkatës.

NDEZJA DHE FIKJA E PAJISJES



Kur ju lidhni pajisjen tuaj me linjën kryesore për herë të parë, ajo do të jetë në modulën "standby" (me energji, por e fikur).

Për të ndezur pajisjen shtypni butonin **A** për 3 sekonda.


Për të fikur pajisjen shtypni përsëri butonin **A** për 3 sekonda. Pajisja është në modulën "standby" (ende me energji).

- Rregulloni temperaturën si të dëshironi duke shtypur butonin **A**.
- Shtypni butonin **A** sa herë që të jetë e nevojshme derisa të vendoset temperatura e dëshiruar.

RREGULLIMI/NDRYSHIMI I TEMPERATURËS NË PAJISJE




- Pasi të ndizet pajisja elektroshtëpiake, mund të kalojnë disa orë që të arrihet temperatura e caktuar. Mos vendosni asnjë ushqim në frigorifer përpara se temperatura të shkojë në parametrin e përzgjedhur.



- Rregullojeni temperaturën sipas dëshirës duke përdorur butonin A.
- Shtypni butonin **A** (disa herë) derisa të ndriçojë treguesi i temperaturës së dëshiruar.
- Kur butoni **A** të shtypet për herë të parë, do të pulsojë vlera aktuale e parametrin ose funksionit të caktuar aktualisht. Sa herë të shtypni më pas butonin **A**, treguesi i parametrave do të lëvizë në parametrin tjetër (nga e djathta në të majtë, në mënyrë ciklike).
- Pas tre sekondash, parametri do të ndalojë së pulsuar. Parametri juaj do të ruhet dhe treguesi përkatës do të ndriçojë në mënyrë të vazhdueshme.


Numrat 1, 3, 5, 7 dhe 9 trgojnë gradët Celsius (°C) në ndarjen frigoriferike të pajisjes elektroshtëpiake.

- Parametri i rekomanduar i temperaturës është +4 °C. Në këtë temperaturë, ruhen më gjatë cilësia dhe freskia e ushqimit.
- Temperatura në ndarjen frigoriferike ndikon edhe në temperaturën në ndarjen ngrirëse. Për një temperaturë më të ulët në ndarjen ngrirëse, vendosni një temperaturë më të ulët në ndarjen frigoriferike.
- Në qoftë se temperatura në dhomën ku është instaluar pajisja elektroshtëpiake është më poshtë se 16 °C, ne rekomandojmë vendosjen e një temperature më të ulët se 4 °C.



- Gjithashtu, kur temperatura e mjedisit është nën 16 °C, ne rekomandojmë që të vendosni manualisht butonin e lëvizshëm tek pozicioni 1 (butoni që lëviz manualisht është i pranishëm vetëm në disa modele pajisjesh).

FUNKSIONI I RITJES SË NGRIRJES




Për të aktivizuar funksionin e ngrirjes intensive (shkulmi i ngrirjes), shtypeni disa herë butonin **A**, derisa të ndriçojë simboli **E**.

- Kur aktivizohet funksioni i ngrirjes intensive, temperatura mund të jetë më e ulët edhe në ndarjen frigoriferike edhe në ndarjen ngrirëse.

i • Kur aktivizohet funksioni i ngrirjes intensive, pajisja elektroshtëpiake do të operojë me maksimumin e fuqisë. Gjatë kësaj kohe, operimi mund të jetë disi më i zhurmshëm.

- Përdoreni këtë parametër pasi të ndizni për herë të parë pajisjen elektroshtëpiake, përpara pastrimit ose 24 orë përpara se të vendosni një sasi të madhe ushqimi.
- Në qoftë se përzgjidhet ndonjë funksion tjetër ndërkohë që funksioni i ngrirjes intensive është aktiv, funksioni i ngrirjes intensive do të çaktivizohet menjëherë.
- Për të fikur funksionin e ngrirjes intensive, shtypeni butonin **A** për të përzgjedhur temperaturën e dëshiruar. Në qoftë se funksioni i ngrirjes intensive nuk çaktivizohet në mënyrë manuale, ai do të fiket automatikisht (pas afërsisht dy ditësh) dhe temperatura do të rikthehet në vlerën më të fundit të vendosur.
- Në qoftë se ka një mungesë të energjisë ndërkohë që funksioni i ngrirjes intensive është aktiv, funksioni do të rifillojë kur të rivendoset furnizimi me energji.

ALARMI I TEMPERATURËS SË LARTË



Në qoftë se temperatura brenda pajisjes elektroshtëpiake është shumë e lartë, do të aktivizohet alarmi zanor (**një ton me intervale**) dhe do të pulsojë simboli **F**.


- Çdo herë që pajisja elektroshtëpiake ndizet me butonin **A**, do të ketë një vonesë 24 orëshe në operimin e alarmit të temperaturës së lartë. Në qoftë se gjatë kësaj periudhe pajisja elektroshtëpiake nuk e arrin temperaturën e ulët të mjaftueshme, do të aktivizohet alarmi.
- Për të pranuar dhe fikur alarmin zanor, shtypeni butoni **A**. Në qoftë se alarmi nuk çaktivizohet në mënyrë manuale, ai do të dëgjohet për pesë minutat e para gjatë çdo ore.
- Kur e shtypni butonin **A** për herë të parë, alarmi do të pranohet dhe do të fiket. Kur e shtypni përsëri butonin **A**, ai tashmë do të funksionojë si një buton për rregullimin e parametrave.
- Simboli **F** pulson derisa pajisja elektroshtëpiake të arrijë një temperaturë të përshtatshme.

ALARMI I DERËS SË HAPUR


Nëse dera e kompartimentit të frigoriferit ose ngrirësit është e hapur për më shumë sesa dy minuta, do të aktivizohet një alarm akustik (bip i vazhdueshëm). Për të pranuar dhe fikur alarmin akustik, shtypni butonin **A** ose mbyllni derën.

BUTONI QË LËVIZET MANUALISHT (VETËM NË DISA MODELE TË PAJISJEVE NOFROST - PA NGRIRJE)

Butoni ndodhet pas koshit të frutave e perimeve. Si përzgjedhje nga fabrika, është pozicioni 2 ose 3.
Nëse nuk është e mundur të arrihet temperatura e duhur, atëherë vendoseni ashtu siç përshkruhet në seksionin "Troubleshooting" (Rregullimi i difekteve).



Pajisjet me lartësi 1850 mm




Pajisjet me lartësi 2000 mm

PAJIMET E BRENDËSHME TË APARATIT

(* pajimet varen nga modelet)


RAFTI



- Për qasje më të lehtë deri te ushqimi dhe kontroll më të mirë mbi përmbajtjen, raftet mund pjesërisht të tërhiqen.
- Raftin mund të rradhitni sipas dëshirës nëpër udhëzues në brendësi të frigoriferit. Nëqoftëse dëshironi ta nxjerrni nga frigoriferi, tërhiqni deri te pika ku udhëzuesi e ndal, pastaj pak e çoni para dhe e nxjerrni nga frigoriferi.


Artikujt ushqimorë që prishen shpejtë i ruani në pjesën e fundit të raftit, ku është më ftohtë.

BARTËSI I SHISHEVE PREJ TELI*



- Disa modele përmbajnë bartës prej teli për shishe. Ai është i mbrojtur nga tërheqëja e befasueshme. Ate mund ta tërhiqni vetëm të zbrazët, ashtu që në pjesën e pasme e çoni dhe e tërheqni kah veti. Bartësin e vëndoni ashtu që gjatësia e shisheve të mos pengojë mbylljen e derës. Ngarkesa maksimale e bartësit është 9 shishe me përmbajtje 0,75 l respektivisht 13 kg peshë totale – shiqo etiketën në anën e djathtë të brendësisë së aparatit.
- Në bartës mund të vëndoni edhe konserva (në thellësi ose gjërësi).

NËNSHTRESA ELASTIKE PËR SHISHE*




- Disa modele kanë nënshtresë elastike në të cilën mund të vëndoni shishe ose konserva.
- Nënshtresën mund të përdorni edhe si nënshtresë në tavolinë për enët e nxehta.

ENA PËR PEMË DHE PERIME ME RREGULLATOR TË LAGËSHTISË (CRISPZONE)




- Ena në fundin e frigoriferit është e dedikuar për ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Siguron lagështi dhe tharje më të ulët të artikujve ushqimorë. Ata nevojitet të jenë mirë të ambalazuara që të mos transmetojnë dhe pranojnë erë dhe lagështi.

Ena përmban rregullator të lagështisë, me të cilin rregulloni lagështinë sa i takon sasisë së artikujve ushqimorë të futur.



Sasitë e vogla të artikujve ushq. – shtypni rregullatorin djathtas;

Sasitë e mëdha të artikujve ushqimorë – shtypni rregullatorin majtas.




- Nxjerrja e enës:
 - Enën tërheqni deri te bllokada, pastaj e çoni para lartas dhe nxjerrni.

ANA E BRENDSHME E DERËS TË PJESËS PËR FTOHJE

Është e pajisur me hapësira (rafte ose enëza), të cilat janë të dedikuara për ruajtjen e djathit, tëlynit, vezëve, kosit etj., tubave, konservave dhe të ngj. Në pjesën e poshtme të derës gjendet hapësira për shishe.




RAFTET NË DERË QË PËRSHTATEN



Lartësia e rafteve në derë mund të përshtatet/rrregullohet sipas preferencave tuaja pa qenë e nevojshme që t'i hiqni ato nga pajisja. Shtypni në të dyja anët dhe lëvizni raftet lart dhe poshtë. Për të hequr një raft nga pajisja, ngrijeni atë sa më larg që të shkojë dhe nxirreni jashtë.

ENA PËR RUAJTJE (MULTIBOX)*

- **MultiBox** ena është e përdorshme për ruajtjen e artikujve ushqimorë me duhma të fuqishme dhe artikujve ushqimorë, të cilët nevojitet të mbrohen nga tharja, p.sh. djathet me myk fisnik, sallamet e freskëta, qepët, tëlyni,...
- Për shkak të kapakut elastik, ena është e mbyllur pa frymë dhe parandalon tharjen e artikujve ushqimorë, kurse duhmat nuk derdhen nëpër tërë pjesën për ftohje.
- Kapakun elastik mund ta përdorim edhe si enë për vezë ose enë për akull.
- Nëqoftëse e përdorni kapakun elastik si enë për vezë, atë e vëndojmë direkt në fundin e enës së derës, kurse pjesën e poshtme të hapur të MultiBox enës e përdorim për ruajtjen e artikujve ushqimorë, të cilët janë të ruajtur në ambalazh të vogël - pashtetat, marmelatat, tubat e vogëla,...




VENTILATORI *

- Ventilatori, i instaluar nën tavan, respektivisht i mshehur në njësinë e ngrirjes, kontribon te rradhitja e njëtrajtshme e temperaturave dhe ul vesimin në sipërfaqet për palosje.

IONIZATORI I AJRIT (IONAIR)*

- **Jonizuesi i ajrit i instauar** në kompartimentin e frigoriferit e mban ajrin gjithmonë të freskët. Si rezultat i kësaj, ushqimi mbetet i freskët dhe me shije për një kohë më të gjatë.
- Jonizatorin e ajrit mund të kyçni dhe shkyçni me tastin e instaluar në shtëpizën e ventilatorit, respektivisht anën e shtyllës për ftohje (varësisht nga modeli).



ADAPTIVE INTELLIGENT TECHNOLOGY

Teknologjia e re me sensorë lejon përshtatjen e funksionimit të pajisjes sipas zakoneve ose sjelljes së përdoruesit. Sistemi adaptues monitoron, analizon dhe regjistron çdo ditë dhe çdo javë funksionimin e pajisjes sipas modeleve të marra. Nëse pajisja mund të parashikojë rritjen e frekuencës së hapjes së derës, pajisja do të ulë temperaturën automatikisht përpara kohe në mënyrë që të parandalojë rritjen e temperaturës së ushqimit pasi dera hapet më shpesh. Pajisja do të parashikojë gjithashtu shtimin e sasive më të mëdha të ushqimit në frigorifer ose ngrirës dhe do të adaptimin duke bërë ftohjen ose ngrirjen në mënyrë më intensive.

RRADHITJA E PREFERUAR E ARTIKUJVE USHQIMORË NË APARAT

Seksionet në ndarjen frigoriferike:

- **pjesa e sipërme:** ushqime në kanaçe, bukë, verë, brumëra etj.
- **pjesa e mesme:** produkte të përditshme, ushqime të gatshme, ëmbëlsira, pije të buta, birra, ushqime të gatuar, etj.
- **Ena FreshZone:** - mish, produkte mishi, sallameri;
- **Ena e frutave dhe perimeve:** fruta të freskëta, perime, sallatra, rrënjë perimesh, patate, qepë, hudhra, domate, lakër turshi, rrepa etj.



Seksionet në ndarjen e derës frigoriferike:

- **Enët në derën e sipërme/të mesme:** vezë, gjalpë, djathë, etj.
- **Enët në derën e poshtme:** pije freskuese, kanaçe, shishe

i **Mos mbani fruta** (banane, ananas, papaja, limona) dhe perime (kungulleshka, patllixhana, kastraveca, specia, domate dhe patate) të ndjeshme ndaj temperaturave në frigorifer.

Seksionet ngrirëse:

- në ngrirje, mbahen ushqime të ngrira (shikoni kapitullin Ngrirja dhe mbajtja e ushqimeve të ngrira).

i **Mos mbani në ngrirje sa më poshtë:** sallatë marule, vezë, mollë, dardha, rrush, pjeshkë, kos, qumësht i kondensuar, salcë kosi dhe majonezë.

RUAJTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË NË FRIGORIFER

VËREJTJE TË RËNDËSISHME PËR RUAJTJEN E ARTIKUJVE USHQIMORË



Përdorimi i rregullt i aparatit, ambalazhimi pëkatës, mirëmbajtja e temperaturës së mirëfilltë dhe marrja në përfillje e higjienës së artikujve ushqimorë ndikojnë shumë në cilësinë e ruajtjes së artikujve ushqimorë.

Merrni në përfillje skadimin e artikujve ushqimorë, të shënuar në ambalazhin e prodhimit.

Artikujt ushqimorë që i ruani në frigorifer, nevojitet të jenë në enët e mbyllura ose të ambalazhuar në mënyrë adekuate, që të mos lëshojnë ose pranojnë duhma dhe lagështi.

Mos ruani në frigorifer lëndë dhezëse, avulluese ose shpërthyes.

Shishet me përbërje të lartë të alkoolit nevojitet të jenë mire të mbyllura dhe në pozicion vertikal.

Disa tretësira organike, vaje eterike në lëvoret e limonave dhe portokajve, acidet në tëlyn dhe të ngj. te kontakti afatgjatë me sipërfaqet nga plastika ose në guarnicionet mund të shkaktojnë dëmtime dhe vjetërsim të parakohshëm.

Nëqoftëse largoheni për gjatë kohë nga shtëpia, nga frigoriferi nxjerrni artikujt ushqimorë që prishen shpejtë.

Nëqoftëse largoheni për gjatë kohë nga shtëpia, nga frigoriferi nxjerrni artikujt ushqimorë që prishen shpejtë.

SHMANGIA E KONTAMINIMIT TË USHQIMIT

Për të shmangur kontaminimin e ushqimit, ju lutemi të respektoni udhëzimet e mëposhtme:

- Hapja e derës për periudha të gjata mund të shkaktojë një rritje të konsiderueshme të temperaturës në ndarjet e pajisjes.
- Pastroni rregullisht sipërfaqet që mund të bien në kontakt me ushqimin dhe sistemet e aksesueshme të kullimit.
- Mishin e papërpunuar dhe peshkun, në frigorifer mbajeni në enë të përshtatshme, në mënyrë që ato të mos jenë në kontakt ose të kullojnë në ushqimet e tjera.
- Në rast se pajisja frigoriferike lihet bosh për periudha të gjata, fiken, shkrijeni, pastrojini, thajeni dhe lëreni derën e hapur për të parandaluar zhvillimin e mykut brenda pajisjes.

MBAJTJA E USHQIMEVE

LLOJI I USHQIMIT	Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)	Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)	Koha e pëafërt e ruajtjes
Mish derri	-1 deri në 4	95	3 ditë
Mish viçi	0 deri në 4	95	deri në 3 javë
Mish qingji	0 deri në 4	95	14 ditë
Mish Pule	0 deri në 4	95	3 ditë
Peshku	0 deri në 4	95	3 deri në 10 ditë
Molusqet	0 deri në 4	95	2 ditë
Mish viçi i njomë	1,5	95	16 javë
Produkte të përditshme (kos, salcë kosi, gjalpë, djathë i butë, feta djathi etj.)	2 deri në 4	95	7 deri në 10 ditë
Panxhar	0	95	3 deri në 5 muaj
Brokoli	0	95-100	10 deri në 14 ditë
Lakër, e re	0	98-100	3 deri në 6 javë
Karrota, të qëruara	0	98-100	4 deri në 5 muaj
Marule, në dimër	0	95-100	2 deri në 3 javë
Hudhër	0	65-70	6 deri në 7 muaj
Lakër Kohlrabi	0	98-100	2 deri në 3 muaj
Lakër Brukseli	0	90-95	3 deri në 5 javë
Lakër kineze	0	95-100	2 deri në 3 muaj
Lakër, varietete të vona	0	98-100	3 deri në 4 muaj
Karrota	0	95-100	2 javë
Lule lakër	0	95-98	2 deri në 4 javë
Selino, normale	0	98-100	2 deri në 3 muaj
Perime me gjethe jeshile	0	95-100	10 deri në 14 ditë
Lakër e kuqe	0	95-100	2 deri në 4 javë
Misër, i ëmbël	0	95-98	5 deri në 8 ditë

LLOJI I USHQIMIT	Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)	Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)	Koha e pëafërt e ruajtjes
Presh	0	95-100	2 deri në 3 muaj
Kërpudha	0	95	3 deri në 4 ditë
Majdanoz	0	95-100	2 deri në 3 ditë
Pastinak	0	98-100	4 deri në 6 muaj
Repa, në dimër	0	95-100	2 deri në 4 muaj
Rrepa	0	98-100	10 deri në 12 muaj
Lule lakër	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë
Qepë	0 deri në 2	65-70	6 deri në 7 muaj
Sparangje	0 deri në 2	95-100	2 deri në 3 javë
Bizele, jeshile	0 deri në 2	95-98	1 deri në 2 javë
Perime të copëtuara	0 deri në 2	90-95	deri në 5 ditë
Lakër Brukseli	0 deri në 2	90-95	1 deri në 2 javë
Kulumbri	0 deri në 2	90-95	3 deri në 4 javë
Kastraveca	4 deri në 10	95	10 deri në 14 ditë
Patate	7 deri në 10	90-95	deri në 9 muaj
Avogado, i paqëruar	7 deri në 10	85-95	deri në 6 javë
Specë	7 deri në 10	90-95	2 deri në 3 javë
Domate	10 deri në 12	85-90	4 deri në 7 ditë
Bizele, fara	< 15	40-50	6 deri në 10 muaj
Dardha	-3	90-95	2 deri në 7 muaj
Kajsi	-1	90-95	1 deri në 3 javë
Luleshtrydhe	0	90-95	3 deri në 7 ditë
Mjedra	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 ditë
Stafidhe	0 deri në 2	90-95	1 deri në 4 javë
Manaferra	0 deri në 2	90-95	14 ditë
Qersh	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 javë
Rrush	0 deri në 2	85	2 deri në 8 javë
Kivi, të qëruara	0 deri në 2	90-95	1 deri në 3 muaj
Pjeshkë	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë


LLOJI I USHQIMIT	Temperatura Optimale e ruajtjes (°C)	Niveli Optimal i ruajtjes së lagështirës (%)	Koha e pëafërt e ruajtjes
Qersh	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 javë
Kivi, të paqëruara	0 deri në 2	90-95	2 deri në 6 muaj
Nektarina	0 deri në 2	90-95	1 deri në 3 javë
Portokalle	0 deri në 2	90-95	2 deri në 4 javë
Hurma	0 deri në 2	90-95	2 deri në 3 muaj
Kumbulla	0 deri në 2	90-95	2 deri në 5 javë
Fruta, të copëtuara	0 deri në 2	90-95	deri në 10 ditë
Mollë	0 deri në 4	90-95	1 deri në 12 muaj
Pjepër	4	90-95	15 ditë
Portokalle	4 deri në 7	90-95	2 deri në 4 javë
Mandarina	5 deri në 8	90-95	2 deri në 4 javë
Mango	10 deri në 13	85-95	2 deri në 3 javë
Pjepër	10 deri në 13	85-95	1 deri në 2 javë
Ananas	10 deri në 13	85-95	2 deri në 4 javë
Limona	11 deri në 13	90-95	2 deri në 3 javë
Shalqi	12 deri në 15	85-95	1 deri në 3 javë
Banane, të qëruara	13 deri në 16	85-95	3 ditë
Qitro	13 deri në 16	90-95	1 deri në 3 javë

MBAJTJA E USHQIMIT NË SIRTARIN FreshZone

(Vetëm në disa modele)

Në ndarjen **FreshZone**, ushqimet qëndrojnë të freskëta më gjatë se në frigoriferin tradicional, duke ruajtur më shumë aromë dhe lëndë ushqyese. Kalbja dhe humbja e peshës ngadalësohet; rrjedhimisht frutat dhe perimet mbeten më gjatë të freskëta dhe natyrale. Për performancë optimale, sirtari duhet të mbyllet plotësisht.

- Kur të blini ushqime, sigurohuni që të jenë të freskëta, pasi kjo do të përcaktojë cilësinë e ushqimit, si dhe sa kohë do të mbahet në frigorifer.
- Ushqimin mbajeni në enë të mbyllura ose në paketime të përshtatshme për të mos e lejuar të lëshojë ose të marrë aroma.
- Merrni ushqimin nga sirtari 30 deri në 60 minuta përpara përdorimit, për të lejuar aromën dhe shijen që të zhvillohen në temperaturën e dhomës.
- Ushqimet e ndjeshme ndaj temperaturës së ulët dhe të papërshtatshme për t'u mbajtur në sirtarin **FreshZone**, përfshijnë sa më poshtë: ananas, avogado, banane, ullinj, patate, patllixhane, kastraveca, bizele, specat (pjepër), pjeprat, shalqinët, kungujt, kungulleshkat etj.



- Për të hequr sirtarin:
 - Tërhiqeni sirtarin jashtë derisa të bllokohet.
 - Pastaj, ngrijeni nga përpara dhe tërhiqeni për ta nxjerrë.

NGRIRJA DHE RUAJTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË TË NGRIRË

PROCESI I NGRIRJES



Sasia maksimale e artikujve ushqimorë të freskët të cilat mundeni menjëheri t'i futni në aparat, është e cekur në etiketën me të dhënat elementare të aparatit. Nëqoftëse sasia është më e madhe, cilësia e ngrirjes është më e dobët, dobësohet edhe cilësia e artikujve ushqimorë të ngrirë.

- Nëqoftëse dëshironi të shfrytëzoni tërë vëllimin e ngrirësit, mund të evitoni tërë sirtarët. Ushqimin palosni direkt në raftë dhe fund të ngrirësit.
 - Te aparatet NO FROST të klasës energjike A+++ sirtarin e poshtëm lejoni në aparat.
- 24 orë para ngrirjes aktivizoni ngrirjen intensive:
 - shtypni butonin **A** aq herë, që të ndriçojë simboli **E**;

Pas kësaj kohe, futni artikujt ushqimorë në hapësirën për ngrirje.

Artikujt ushqimorë të freskët nuk guxon të preken me pakotë e ngrira!
Vendi më i përshtatshëm për ngrirjen e sasisë së madhe të artikujve ushqimorë është hapësira e sipërme.

- Për ngrirje të sasive më të vogla (1-2 kg), rregullimi i ngrirjes intensive nuk nevojitet.
- Pas 24 orësh, artikujt ushqimorë mund të transferoni në hapësirat tjera të ngrirësit dhe sipas nevojës përsëritni procesin e ngrirjes.

VËREJTJE TË RËNDËSISHME PËR NGRIRJEN E ARTIKUJVE USHQIMORË



Në ngrirës ngrini vetëm artikuj ushqimorë të përshtatshëm. Le të jenë cilësore dhe të freskëta.

Përzgjedhni artikullit ushqimorë ambalazh adekuat dhe ambalazhoni me rregullsi.

Ambalazhi le të mos lëshojë lagështinë dhe ajrin, që ata të mos thahen dhe humbim vitaminat.

Artikujt ushqimorë të ambalazhuar i shënoni me të dhënat për llojin, sasinë dhe datën e ngrirjes.

Është e rëndësishme që artikujt ushqimorë të ngrijnë sa më shpejtë, prandaj qeskat të jenë sa më të vogla. Para ngrirjes, artikujt ushqimorë i ftohni.

RUAJTJA E ARTIKUJVE USHQIMORË TË NGRIRË INDUSTRIALISHT

- Te ruajtja dhe përdorimi i artikujve ushqimorë të ngrirë merrni në përfillje udhëzimet e prodhuesit. Në ambalazh janë të shënuara temperatura dhe koha e ruajtjes.
- Përzgjedhni vetëm artikujt ushqimorë me ambalazh të padëmtuar, të ruajtura në ngrirës te temperaturat -18°C ose më të ulëta.
- Mos bleni artikuj ushqimorë të mveshur me acar, sepse ata kanë qenë shumë herë të shkruara dhe cilësia e tyre është më e dobët.
- Te transportimi siguroni artikujt ushqimorë nga shkruirja. Rritja e temperaturës shkurton kohën e ruajtjes dhe dobëson cilësinë e tyre.

KOHA E RUAJTJES SË ARTIKUJVE USHQIMORË TË NGRIRË

KOHA E PREFERUAR E RUAJTJES NË NGRIRËS

Artikulli ushqimorë	Koha
pemët, mishi i lopës	prej 10 deri në 12 muaj
perimet, mishi i viçit, shpendia	prej 8 deri në 10 muaj
mishi i egërsirave	prej 6 deri në 8 muaj
mishi i derrit	prej 4 deri në 6 muaj
mishi i prerë	4 muaj
buka, paroritë, gjellat e gatshme, peshku	3 muaj
zorrët	2 muaj
suxhuku i tymosur, peshku i yndyrtë	1 muaj

SHKRIRJA E ARTIKUJVE USHQIMORË TË NGRIRË

Me ngrirjen e artikujve ushqimorë, mikroorganizmat nuk zhduken. Pas shkrirjes, ata aktivizohen dhe së shpejti e prishin artikullin ushqimorë. Artikujt ushqimorë të shkrirë harxhoni menjëherë.

Shkrija e pjesërishme ul vlerën e artikujve ushqimorë, posaçërisht pemëve dhe perimeve dhe gjellave të gatshme.

SHKRIRJA E APARATIT

SHKRIRJA AUTOMATIKE E FRIGORIFERIT

Frigoriferi nuk nevojitet të shkrihet, akulli në murinë e fundit të brendësisë së frigoriferit shkrihet automatikisht.

Akulli i tubuar, gjatë pushimit të kompresorit shkrihet vetë. Pikat rrjedhin nëpër vanën në murinë e fundit të frigoriferit në enëzën mbi kompresor, e këtu avullohen.

Në rast se në murinë e fundit në brendësi të frigoriferit tubohet shtresë e madhe e akullit (3-5 mm), shkyçni aparatin dhe shkrihi akullin me dorë.

SHKRIRJA E NGRIRËSIT NO FROST

- Shkrirja e ngrirësit NO FROST është automatike. Paraqitja eventuale e acarit automatikisht zhduket.
- Shfaqja e akullit, respektivisht shtresave të ngricës në pjesën për ngrirje, mund të jetë pasojë e përdorimit abnormal të aparatit (hapja e shpeshtë e derës, dera e hapur gjatë kohë, dera jo e mbyllur mirë, ...). Në këto raste shkyçni aparatin, nxjerrni artikujt ushqimorë nga ngrirësi dhe siguroni që të mos shkrihen.

Pastroni dhe thani brendësinë e ngrirësit, kurse, paraprakisht se të futni artikujt ushqimorë në ngrirës, aparatin e kyçni dhe përzgjedhni rregullimin e dëshiruar.

PASTRIMI I APARATIT



Para pastrimit, shkyçni aparatin nga rrjeta elektrike – shkyçni aparatin (shiqoni kapitullin Kyçja/shkyçja e aparatit) dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.

- Për pastrimin e të gjithë sipërfaqeve përdorni **leckë të butë**. Lëndët për pastrim që përmbajnë **lëndë abrazive, acide ose tretësira, nuk janë të përshtatshme**, sepse dëmtojnë sipërfaqen!


Jashtësinë e aparatit e pastroni me ujë, resp. me shukumë të lehtë të sapunit. Sipërfaqet e llakuara ose nga alumini mund të pastrohen me ujë të vokët, të cilit i keni shtuar lëndë të lehtë për pastrim. Lejohet përdorimi i lëndëve për pastrim me përbërje të ulët të alkoolit (p.sh. lëndë pastruese për xhama). Për materialet nga plastika nuk lejohet përdorimi i lëndëve për larje që përmbajnë alkool.




Brendësinë e aparatit e pastroni me ujë të vokët, të cilit i shtoni pak **uthull**.



- Mos i lani pjesët e aksesorëve të brendshëm të pajisjes elektroshtëpiake në lavastovilje, pasi mund të dëmtohen.




- Nën pllakën për ftohje e cila ftoh brendësinë e frigoriferit gjenden olluku dhe hapësira ku derdhet uji i shkrirë. Olluku dhe hapësira nuk lejohet të shtupohen, prandaj le të kontrollohen më shpesh dhe sipas nevojës të pastrohen (p.sh. me karthi prej plastike).
- Shtresat me acar ose akull me trashësi 3-5 mm, rritin shpenzimin e energjisë elektrike, prandaj rregullisht i evitoni (nuk vlen për ngrirësin NO FROST). Mos përdorni sende të mprehta, tretësira ose spreje.




- **Kondensatori** në murinë e fundit nevojitet të jetë gjithmonë i pastër, pa pluhur ose mbeturina për shkak të tymit kuzhinor. Me furçë jometalike ose fshesë korenti kohë pas kohe pastroni pluhurin.
- Pas pastrimit, kyçni aparatin dhe futni artikujt ushqimorë.

EVITIMI I PENGESAVE

Pengesa:	Shkaku, resp. evitimi
Pas kyçjes në rretë, aparati nuk punon:	<ul style="list-style-type: none"> • Kontrolloni se a ka tension në prizë dhe a është aparati i kyçur.
Sistemi për ftohje gjatë kohë punon pandërprerë: 	<ul style="list-style-type: none"> • Temperatura tejet e lartë e rrethit. • Hapja e shpeshtë e derës, resp. dera e hapur gjatë kohë. • Dera e mbyllur jo mirë (diçka në mes të derës, dera e varur, kontrolloni guarnicionin, etj.). • Futur sasia tejet e madhe e artikujve ushqimorë të freskët. • Sensori në frigorifer (A) është mbuluar me artikuj ushqimorë të freskët. Mundësoni qarkullimin e ajrit rreth sensorit (e kanë vetëm disa modele). • Ftohja e dobët e kompresorit dhe kondensatorit. Kontrolloni qarkullimin e ajrit pas aparatit, pastroni kondensatorin.
Tubimi i tepërt i akullit në murinë e fundit të brendësisë së frigoriferit është pasojë e:	<ul style="list-style-type: none"> • Hapjes së shpeshtë të derës, resp. dera e hapur gjatë kohë. • Futjes së ushqimit të ngrohtë në frigorifer. • Prekjes së ushqimit ose enës së murisë së fundit me murinë e brendëshme të frigoriferit. • Puthitjes së dobët të derës. • Ndotjes ose dëmtimit të guarnicionit, pastroni ose ndërroni.
Shfaqja e akullit, respektivisht shtresave të ngricës në ngrirës është pasojë:	<ul style="list-style-type: none"> • Hapja e shpeshtë e derës, respektivisht dera e hapur gjatë kohë. • Dera jo e mbyllur mirë. • Guarnicioni i dobët i derës. • Nëqoftëse guarnicioni është i ndotur ose i dëmtuar, ate pastroni, respektivisht ndërroni.
Vesimi i raftit mbi sirtarët:	<ul style="list-style-type: none"> • Është dukuri kalimtare, të së cilës nuk munda t'i shmangemi në periudhën e temperaturave të larta dhe lagështisë në ambient. Dukuria zhduket vetë, pasi që normalizohen temperatura dhe lagështia. Rekomandojmë pastrim më të shpeshtë të sirtarëve dhe fshirje të pikave kohë pas kohe. • Hapni rregullatorin e lagështisë. • Futni artikujt ushqimorë në qeska ose ambalazh tjetër.

Pengesja:	Shkaku, resp. evitimi
Uji rrjedh nga frigoriferi:	<ul style="list-style-type: none"> • Hapësira për daljen e ujit e shtupuar, resp. uji i shkrirë rrjedh pranë ollukut për tubimin e ujit. • Pastroni hapësirën e shtupuar, p.sh. me karthi plastike. • Shtresën tejet të trashë të akullit e shkrini me dorë (shiqoni Shkrirja e aparatit).
Butoni F rreh:	<ul style="list-style-type: none"> • Hapja e shpeshtë e derës, resp. dera e hapur gjatë kohë. • Dera jo mirë e mbyllur (diçka në mes të derës, dera e varur, guarnicioni i dëmtuar,...). • Gjatë kohë pa energji elektrike. • Sasia e madhe e futur e artikujve ushqimorë të freskët.
Hapja e derës e vështirësuar:	<ul style="list-style-type: none"> • Nëqoftëse dëshironi që derën e posambyllur të ngrirësit sërish të hapni, mund të hasni në vështirësi. Te hapja e derës ca ajër i ftohtë del nga aparati, ate e zvendëson ajri i ngrohtë nga rrethi. Te ftohja e ajrit në fjalë shkaktohet nënshtypje, kjo është shkak për hapjen e vështirësuar e derës. Pas ca minutash gjendja normalizohet dhe dera hapet pa vështirësi.
LED ndriçimi nuk funksionon:	<ul style="list-style-type: none"> • Në rast se LED ndriçimi nuk funksionon, thirrni serviserin. • LED ndriçimin mos e riparoni vetë, sepse mund të vijë në kontakt me tensionin e lartë!
Temperatura tejet e lartë në ngrirës:	<ul style="list-style-type: none"> • Rregulloni lëputën me dorë (gjetet pas enës për pemë dhe perime) ashtu që shtypni pullën dhe e lëvizni në pozicionin 1 (e kanë vetëm disa modele).



Nëqoftëse asnjë nga shkaqet nuk përshtatet, thirrni servisin më të afërm të autorizuar dhe tregoni llojin, modelin dhe numrin serik nga etiketa për të dhënat elementare të aparatit që gjendet në brendësi të aparatit.

INFORMATA PËR ZHURMËN E APARATIT

Ftohjen në aparatet për ftohje dhe ngrirje mundëson sistemi për ftohje me kompresor (te disa aparate edhe ventilatori), e kjo shkakton edhe ca zhurmë. Sasia e zhurmës varet nga pozicionimi, përdorimi i rregullt dhe vjetërsia e aparatit.

- **Pas nisjes** së aparatit, funksionimi i kompresorit (zhurma e lëndës fluide) resp. derdhja e brendshme e lëndës fluide për ftohje gjatë funksionimit të tij është më e lartë. Kjo nuk është shenjë e prishjes dhe nuk ka ndikim në jetëzgjatjen e aparatit. Pas një kohe, me funksionimin e aparatit, zhurma e tillë do të zvogëlohet.
- Disa herë, te funksionimi i aparatit paraqiten edhe **zhurma të pazakonshme ose të larta**, të cilat janë për aparatit të pazakonshme dhe më së shumti janë pasojë e pozicionimit jo të mirë:
 - Aparati le të qëndrojë rrafsh dhe stabil në dysheme të fortë.
 - Nuk lejohet të preket me muritë ose elementet fqinje.
 - Kontrolloni se a janë pajimet e brendëshme në vend të vet, resp. të mos bëjnë rrapëllimë konservat, shishet ose enët tjera, të cilat fërkohen ndërmjet veti.
- Për shkak të ngarkesës më të madhe të sistemit për ftohje te hapja e shpeshtë e derës, derës së hapur gjatë kohë, futjes të sasisë së madhe të artikujve ushqimorë, kyçjes së ngrirjes intensive ose ftohjes, përkohësisht mund të rritet zhurma e aparatit.

MARRIM TË DREJTË PËR NDRYSHIMET TË CILAT NUK NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E APARATIT.

COMBI FS600 ADV SY



783548

sq (02-20)